Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/439
Datë: 02.07.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** akreditimi dhe validimi i Institucionit "PRIME EDUCATION SH.P.K" me adresë: Rr. Tirana, në Prishtinë, Republika e Kosovës, për kualifikimet:

   1.1. **Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit,** Niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim i bazuar në Standard Kombëtar (D) me 50 kredi të AAP.

   1.2. **Instalues Elektrik**, Niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 41 kredi të AAP.

   1.3. **Metalpunues,** Niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 51 kredi të AAP.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "PRIME EDUCATION SH.P.K" ka parashtruar në AKK kërkesën për akreditim dhe validim të institucionit për kualifikimet: Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit, niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim i bazuar në Standard Kombëtar (D) me 50 kredi të AAP, Instalues Elektrik, niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 41 kredi të AAP si dhe Metalpunues, niveli IV i KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 51 kredi të AAP. AKK ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të institucionit dhe pasi aplikacioni i ka plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së e njëjta është aprovuar nga ana e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe është vazhduar tutje me procedurat tjera të procesit. AKK ka caktuar ekipin vlerësues të ekspertëve, të cilët me datë 20.10.2023 kanë shqyrtuar dosjen

e aplikimit të institucionit "PRIME EDUCATION" SH.P.K. Ekipi i eksperteve me datë 03.11.2023 ka realizuar vizitën në këtë institucion, ndërsa raportin vlerësues përfundimtar për kualifikimin Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit, niveli IV i KKK e ka përpiluar me datë 08.04.2024. Bazuar në dosjen e aplikimit dhe të gjeturave nga vizita në këtë institucion, ekipi i eksperteve ka konstatuar se gjendja e sallave mësimore, paisjeve për realizim të anës praktike dhe infrastruktura në përgjithësi nuk janë të përshtatshme për arritjen e rezultateve mësimore të kandidatëve në Institucionin "PRIME EDUCATION" SH.P.K. Institucioni nuk ka krijuar portofolio të kandidatëve sepse ende nuk ka filluar me vijimin e trajnimit.

Ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se institucioni "PRIME EDUCATION" ofron pjesërisht kushte për mbarëvajtjen e procesit aftësues për profilin Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit, niveli IV i KKK, duke përfshirë edhe standardet e kërkuara nga AKK, përjashtimisht mungesës së hapësirës në punëtori ose laborator për realizimin e pjesës praktike dhe numrit të vogël të paisjenve në këto hapsira. Ekipi i ekspertëve gjatë vizitës në këtë institucion ka kërkuar disa dokumente dhe dëshmi shtesë të cilat institucioni i ka dorëzuar me datë 02.04.2024. Ekipi i ekspertëve bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit shtesë, vizitës tek institucioni si dhe gjendjes së sallave për mesim teorik, mungesës së punëtorve dhe laboratoreve për realizimin e pjesës praktike, vjen në përfundim se kapacitetet e Qendrës për Aftësim Profesional "PRIME EDUCATION" nuk janë të mjaftueshme për të filluar punën me trajnime në fushën Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit.

Kabinetet që posedon "PRIME EDUCATION" nuk kanë ndriqim natyral, sistem të ventilimit dhe klimatizimit, ndërtesa është objekt banesor ku nuk ofron kushte për këtë profil.

Ekipi i ekspertëve në raportin vlerësues për akreditim për kualifikimin Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit ka konstatuar se:

1. Objekti i qendrës nuk është në përputhje me nevojat e aftësimit profesional (hapsira në qendër është shumë e vogël, nuk ka ndriçim natyral, dyshemeja është e rrëshqitëshme nuk i plotëson kushtet, nuk ka hapsirë për tavolinat e punës, mungon depoja për ruajtjen e matarialeve shpenzuese, depo për ruajtjen e bombolabe të gazit, nuk ka hapsirë për vendosjen e mureve montazh (ishujve). Pasi që qendra është në objekt banesor nuk lejohet ndotja akustike dhe ndotja e ambientit.

2. Testet për pjesën teorik duhet të përputhen me rezultatet mësimore dhe të jen të hartuara me opsione dhe jo vetëm pyetje të hapura.

3. Listat e kontrollit për pjesën praktike duhet te jen për secilin rezultat mësimor modul. Listat e dërguar nuk nuk i kanë të qartësuara kriteret e vlerësimit / janë bartur vetëm RM si kritere të vlerësimit, gjë e cila nuk është në rregull sepse një RM mund të ketë disa kritere te vlerësimit

4. Tek testet praktike duhet të specifikohen saktë detyrat praktike

5. "Prime Education" i mungon paketa mësimor, po ashtu i mungojnë një provim final si për pjesën teorike ashtu edhe për atë praktike)

6. Mungon plani instruksional, i realizimit të trajnimit (duhet të jetë së pak për një RM).

7. Mungon specifikimi se cilat module është planifikuar të bahen në qendrën "Prime Education" e cilat në kompani
8. Mungon specifikimi se ku dhe si do të bëhet vlerësimi përfundimtar i pjesëmarrësve në kualifikim,
9. Të hartohet një formular për vlerësim në vendin e punës,
10. "Prime Education" duhet të ketë klasa me ndriçim natyral dhe ajrosje (nuk mjafton vetëmndriçimi artificial),
11. "Prime Education" duhet të furnizohet me tavolina të punës, të furnizuara me vegla përcjellëse (jo vetëm banka si për pjesën teorike)
12. Mungojnë instruksionet e sigurisë për secilën vegël, makinë dhe pajisje si ngaqendra po ashtu edhe nga kompania,
13. Qendrës i mungon personeli i certifikuar për sigurinë në punë,
14. Dyshemeja e kabineteve , është shumë e rrëshqitshme (paraqet rrezik për kandidatët dhe stafin),
15. Kabineti nuk është i furnizuar me pajisje personale mbrojtëse në raport me numrin e kandidatëve (secili kandidat të ketë pajisjet e veta personale)
16. Të modifikohet rregullorja dhe të prezantohen të dhëna se si planifikon Instituti Prime Education të rregullojë njohjen e kredive me qendra të tjera të aftësimit?
17. Nuk është merret parasysh udhëzimi administrativ për mësim në vendin e punës,
18. Plani zhvillimor për politikat e stafit duhet të jetë i përshkruar në detaje (mungon saktësisht se në cilën periudhë kohore dhe në cilat module profesionale do të trajnohet stafi dhe në cilat institucione apo në cilat qendra do të kryhet trajnimi),
19. Të sillet dëshmia e hulumtimit të tregut të punës për këtë program të kualifikimit (hulumtimi për tu bindur se tregu ka nevojë për këtë profil),
20. Në planin zhvillimor nuk ka përshkrim për investime në material shpenzues, investime në makineri dhe pajisje te reja;
21. Në marrëveshje të bashkëpunimit me kompani nuk ceket kush e bënë sigurimin aksidental;
22. Marrëveshjet e bashkëpunimit të jenë të lidhura me veprimtaritë e secilit modul. Në mënyrë që kandidatët të munden që njohurit e fituara ti praktikojnë;

23. Në marrëveshjet e bashkëpunimit "Prime Education" me kompanitë nuk e ka të cekur se cilat module do te realizoj bashkarisht edhe si do te jete vlerësimi;

24. Sa i përket pjesës praktike sipas prezantimeve që janë bërë nuk plotësohen kushtet për arritjen e njohurive dhe shkathtësive të moduleve respektivisht RM-ve përkatëse. Mungojnë pajisje kryesore, nuk ka material shpenzues e as vegla të treguara, e po ashtu salla e paraparë për realizimin e këtij aktiviteti është e vogël dhe e pamjaftueshme! Në përgjithësi nuk ka kushte të realizimit të praktikës në qendër edhe pse është e paraparë në pothuajse secilën RM.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të aplikacionit, realizimit të vizitës dhe komenteve shtesë të institucionit "PRIME EDUCATION" ka përpiluar raportet vlerësuese për kualifikimin Metalpunues, niveli IV i KKK, duke i rekomanduar Këshillit Drejtues Mosakreditim të institucionit për këtë kualifikim. Ekipi i ekspertëve ka konstatuar se: Institucioni "PRIME EDUCATION" ka laboratorin 3 i cili posedon 55.9 m2 dhe shfrytëzohet si hapsirë për aktivitetet praktike të programit Metalpunues, në të gjenden 4 kabina të cilat nuk janë ndërtuar sipas standardeve profesionale, materiali me të cilin janë të ndarë kabinat është material rrezatues i cili paraqet rrezik nga rrezatimi si për trajnerët po ashtu edhe për pjesëmarrësit në trajnim po ashtu kabineti për pjesën e praktikës ka dysheme të rreshqitshme dhe nuk posedon tovolin të punës me vegla dhe paisje përcjellse për modulet dhe rezultatet e përshkruara në programin e trajnimit. Ekipi i eksperteve ka konstatuar se gjendja e sallave mësimore, pajisjeve për realizim të anës praktike dhe infrastruktura në përgjithësi nuk janë të përshtatshme për arritjen e rezultateve mësimore. Bazuar në të gjeturat e ekipit të ekspertëve institucioni "PRIME EDUCATION" ofron shumë pak kushte për mbarëvajtjen e procesit të aftësimit për profilin Metalpunues, duke përfshirë edhe standardet e kërkuara nga AKK, përjashtimisht mungesës së hapësirave në punëtori dhe/ose laboratorë për realizimin e pjesës praktike dhe numrit të vogël të pajisjeve në këto hapësira.

Ekipi i ekspertëve vlerësues gjatë vizitës tek pala aplikues ka kërkuan disa dokumente dhe dëshmi shtesë të cilat u dorëzuan nga institucioni me datë 02.04.2024. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, të gjeturave nga vizita dhe të materialeve shtesë të pranuara ekipi i ekspertëve ka konstatuar se: kapacitetet e Qendrës për Aftësim Profesional "PRIME EDUCATION" nuk janë të mjaftueshme për të filluar punën me trajnime në profilin Metalpunues.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dokumentacionit, realizimit të vizitës dhe komenteve shtesë të institucionit "PRIME EDUCATION" ka përpiluar raportet vlerësues për kualifikimin Instalues Elektrik niveli IV i KKK dhe ka konstatuar se: Laboratori për kualifikimin Instalues Elektrik për nga hapsira nuk i përmbush kriteret për trajnim sepse nuk ka ndriçim natyror dhe është pa dritare, mungon ajrosja. Në fotot e dërguara dhe nga vizita që i kemi bërë Qendrës "PRIME EDUCATION" shohim se nuk ka ndryshuar asgjë, tre kabina të cilat nuk janë të ndërtuara sipas standaredve profesionale dhe nuk i shohim pajisjet me të cilat do të kishin kry ushtrimet kandidatët. Gjatë ditës së vizitës,ekipi i ekspertëve ka diskutuar në detaje metodat, format dhe instrumentet e vlerësimit, certifikimit dhe të testimit. Megjithatë përmes rekomandimeve kemi pritur përmirësim të gjendjes pasi që gjendja e sallave mësimore, pajisjeve për realizim të anës praktike dhe infrastruktura në përgjithësi nuk janë të përshtatshme për arritjen e rezultateve mësimore.

Institucioni "PRIME EDUCATION" ofron shumë pak kushte për mbarëvajtjen e procesit të aftësimit për profilin Instalues Elektrik, duke përfshirë edhe standardet e kërkuara nga AKK, përjashtimisht mungesës së hapësirave në punëtori dhe/ose laboratorë për realizimin e pjesës praktike dhe numrit të vogël të mjeteve të punës (nuk kanë numrin e cekur për pajisjet dhe veglat me të cilat do të kryen detyrat praktike) në këto hapësira. Kabineti që posedon institucioni për ofrimin e kualifikimit Instalues Elektrik nuk ka ndriçim natyral, sistem të ventillimit dhe klimatizimitsi dhe ndertesa është objekt banesor.
Ekipi i ekspertëve gjatë vizitës tek pala aplikuese ka kërkuar disa dokumente dhe dëshmi shtesë të cilat u pranuan me datë 02.04.2024. Kështu bazuar në dosjen e aplikimit, të gjeturave nga vizita dhe shqyrtimit të materialeve shtesë ekipi i ekspertëve ka konstatuar se: kapacitetet e Qendrës për Aftësim Profesional "PRIME EDUCATION" nuk janë të mjaftueshme për të filluar punën me trajnime në profilin Instalues Elektrik.

Këshilli Drejtues i AKK-së bazuar në raportet vlerësuese të ekipeve të eksperteve lidhur procesin e akreditimit dhe validimit të Institucionit "PRIME EDUCATION" SH.P.K" për kualifikimet: Instalues i ngrohjes, Klimatizimit, Ujësjellësit dhe Kanalizimit, niveli IV i KKK, Instalues Elektrik, niveli IV i KKK dhe Metalpunues, niveli IV i KKK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "PRIME EDUCATION" SH.P.K"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së